

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi, dhe gjyqtarët Atdhe Berisha dhe Luan Berisha, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2. lidhur me par.1. të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.167/14 të datës 27.04.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurores së shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij av. M. Q., më datën 12.04.2016, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. K., nga i ati Rr. dhe e ëma E. – e lindur H., data e lindjes... në fshatin Kosavë Komuna e Dragashit, me banim në Prizren, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se prej datës 04.05.2012 e deri më 31.nëntor.2012 në Prizren në cilësi të personit zyrtar – Drejtorit të Spitalit rajonal prim.Dr.Daut Mustafa në Prizren, duke e shfrytëzuar autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tija me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personat e tjerë, në atë mënyrë që në kundërshtim me nenin 8 par.1. të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës, pa shpallur konkurs merr vendim për pranimin në marrëdhënie pune në kohë të caktuar A. M. me vendimin nr. 11/07 të datës 04.05.2012 dhe të njejtën e punëson në vendin e punës mami, në boksën e lindjes, Departamenti për nëna dhe fëmijë në Spitalin rajonal prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren. Më datën 30.11.2014 poashtu merr vendimin me nr.11/45 për pranimin në marrëdhënie pune në kohë të caktuar S. Th., në punë dhe detyrat e punës së motrës akusherike në Repartin akusherik të Departamentit për nëna dhe fëmijë të Spitalit rajonal prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, më datën 03.12.2012 lidhë kontratën e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar me nr.5/31 me S. Th. për vendin e punës motër akusherike në Departamentin e njejtë për periudhën kohore prej 01.12.2012 gjerë më 31.12.2012, me datën 10.01.2013 lidhë kontratën e punës për kohë të caktuar me nr.1247 me S. Th. për vendin e punës mami në Repartin gjinekologjik për periudhën kohore prej 01.01.2013 deri më 31.dhjetor.2013 dhe në fund të dhjetorit të vitit 2013 lidhë kontratën për marrëdhënien e punës në kohë të pacaktuar nr.1247 me S. Th., me ç rast rëndë e shkel Ligjin e punës së Republikës së Kosovës, ndërsa këtyre dy të

punësuarava i sjellë dobi të kundërligjshme në vlerën e të ardhurave personale të paguara.

-këso dore ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2.lidhur me par.1. të KPK.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 3, 6, 34, 41, 42, 43, 66,67, 316 par.2.lidhur me par.1. të KPK ia shqipton

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtuqë ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 /një/ viti, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti në afatin e verifikimit prej 2 /dy/ viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushalin gjyqësor në shumën prej 300 Euro, në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.167/14 të datës 27.04.2015, kundër të akuzuarit M. K. për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2. lidhur me par.1. të KPK. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim duke elaboruar verbalisht në seancë Prokurorja e Shtetit ka deklaruar se këtu i akuzuari duke e shfrytëzuar autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tija dhe në kundërshtim me nenin 8 par.1. të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës pa shpallur konkurs merr vendim për pranimin në marrëdhënie pune në kohë të caktuar të A. M. me vendimin nr.11/27 të datës 04.05.2012, me datën 30.nëntor.2012 poashtu merr vendimin me nr.11/45 për pranimin në marrëdhënie pune në kohë të caktuar të S. Th. në punë dhe detyrat e punës së motrës akusherike në repartin akusherik të Spitalit rajonal prim. Dr.Daut Mustafa në Prizren. Me datën 03.12.2012 poashtu lidhë kontratën e marrëdhënies së punës në kohë të caktuar me S. Th., kontrata nr.5/31 për vendin e punës motër akusherike në departamentin e njëjtë në periudhën kohore prej 01.12.2011 gjerë më 31.dhjetor.2012. Më datën 10.01.2013 lidhë kontratën e punës për kohë të caktuar me nr.1247 me S. Th. për vendin e punës mami në Repartin gjinekologjik për periudhën kohore prej 01.01.2013 gjerë më 31.12.2013. Ndërsa në fund të dhjetorit të vitit 2013 lidhë kontratën për marrëdhënie të punës në kohë të pacaktuar me S. Th. me ç rast e shkel edhe Ligjin e punës së Republikës së Kosovës. Andaj, konsideron se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale keqëpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KP, pasi që kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar dhe nga provat materijale. Ka propozuar që gjykata ta shpallë fajtor dhe të ia shqiptoi dënimin e paraparë me ligj.

Mbrojtësja e të akuzuarit av. M. Q. fjalën përfundimtare poashtu e ka parashtruar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit në seancë ka deklaruar se i akuzuari M. K. ka nënshkruar kontratën e punës bazuar në rezultatet e konkursit në cilësi të drejtorit të Spitalit rajonal prim. Dr.Daut Mustafa në Prizren. Se veprimet e tij kanë qenë brenda kërkesave ligjore është vërtetuar edhe nga shkresa e drejtorit dhënë administratës e datës 10.12.2013 e cila e ka përmbajtjen “S. Th. mami në akusheri ti vazhdohet kontrata sipas ligjit”. Pikërisht nga kjo shkresë vërtetohet fakti se pikësnyimi i tij kryesor ka qenë zbatimi i ligjit. Qëllimi i tij në cilësi të personit zyrtar ka qenë që të kryen shërbime adekuate dhe me kohë për pacientet me nevojë. Aktakuza ka dështuar ta provoi se cili ishte qëllimi, cili përfitimi e cili dëmi. Andaj, ka propozuar që të lirohet nga akuza pasi që nuk është provuar se i njejtë e ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjatë shqyrtimit gjyqësor – në procedurën e provave është dëgjuar dëshmitari Q. G., Drejtor i administratës në Spitalin rajonal të Prizrenit i cili ka deklaruar se A. M. është punësuar me kontratë për një muaj prej datës 01.12.gjerë më 31.12.2012 pastaj prej datës 01.01.2013 deri më 31.12.2013 i është vazhduar kontrata në kohë të caktuar dhe se për këtë punësim nuk ka patur konkurs as për herën e parë për një muaj e as për herën e dytë kur i është vazhduar kontrata për një vit, dhe se si është punësuar e dinë vet i akuzuari. Pastaj prej periudhës 01.01.2014 kur i është vazhduar kontrata në kohë të pacaktuar poashtu nuk ka patur konkurs. Ndërsa sa i përket S. Th. e din që e njejtë është pranuar poashtu pa konkurs dhe se nuk ka qenë fare në listë të pritjes. Poashtu, ka theksuar se këtu të akuzuarit i është bërë me dije se A. M. dhe S. Th. nuk mund të iu vazhdohen kontratat për kohë të caktuar – të pacaktuar pasi që nuk ka patur konkurs.

Dëshmitarja S. Th. ka theksuar se ka konkuruar për vendin e punës si motër pasi që punëtorja ka shkuar në pushim të lehonisë dhe e ka zëvendësuar të njejtën dhe atë për 8-9 muaj dhe se edhe tani punon në spital, e ka kontratën në afat të pacaktuar. Punëtorja të cilën e ka zëvendësuar, S. Q. është kthyer në vendin e vet të punës dhe se pas skadimit të kohës të cilën e ka zëvendësuar të njejtën nuk ka konkuruar në ndonjë vend tjetër të punës.

Dëshmitarja A. M. ka theksuar se e ka zëvendësuar punëtoren B. Sh., nuk e din për sa kohë dhe se nuk e dinë se a është kthyer punëtorja e njejtë në vendin e punës, nuk e din kur e ka marrë kontratën e punës për kohë të pacaktuar, e dinë që vetëm njëherë ka konkuruar.

Nga shkresa e datës 17.10.2011 vërtetohet se këtu i akuzuari në cilësi të Drejtorit të Spitalit rajonal të Prizrenit i është drejtuar Sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e shëndetësisë në lidhje me arsyeshmërinë e pranimit të infermiereve të reja si zëvendësim pasi që ka patur mungesa të stafit.

Nga formulari i kërkesës për autorizim të rekrutimit vërtetohet se janë kërkuar mjek specialist, infermiere dhe mami për kohë të caktuar derisa të kthehen nga pushimi punëtorët.

Nga njoftimi i datës 02.05.2012 vërtetohet se infermieret – mamitë për punë në sallat e lindjes prej nr.rendor prej 1 deri në 6 janë kandidatet të cilat kanë hyrë në listen e pritjes në kohë të caktuar sipas repartit të akusherisë dhe sallave të lindjes.

Nga kronologjia e rasteve të punësimit e datës 26.05.2015 vërtetohet se me datën 02.12.2011 është bërë shpallja e konkursit me nr. të referencës 9/2 në bazë të pikës 1. dhe 2. të Nenit 8. të Ligjit të punës për vendin e punës mami boksi, dhe se A. M. ka qenë e renditur si e dyta në ranglistë.

Nga vendimi nr.ll/28 në emër të A. M. vërtetohet se e njejta është pranuar në marrëdhënie pune në kohë të caktuar në vend të B. Sh. në punët dhe detyrat e punës së mamisë në boksën e lindjes, duke filluar prej datës 15.05.2012.

Nga kontrata e marrëdhënies së punës me nr.ll/28 në emër të A.M. vërtetohet se e njejta është pranuar në kohë të caktuar me kontratë në periudhën kohore prej 15.05.2012 gjerë më 31.12.2012.

Nga kontrata e marrëdhënies së punës me nr.l233 vërtetohet se me A. M. është lidhur kontrata e punës për kohë të pacaktuar më datën 13.12.2012.

Në bazë të vendimit nr.ll/45 të datës 30.11.2012 S. Th. është pranuar si motër akusherike në marrëdhënie pune në kohë të caktuar në punët dhe detyrat e punës së motrës akusherike në Repartin akusherik duke filluar prej datës 01.12.2012 gjerë më 31.12.2012.

Nga kontrata me nr.5/31 e datës 03.12.2012 vërtetohet se është lidhur kontrata e punës për kohë të caktuar me S. Th. për periudhën kohore prej 01.12.2012 deri më 31.12.2012.

Nga kontrata e marrëdhënies së punës me nr.l247 për kohë të caktuar vërtetohet se S. Th. është pranuar në Spitalin rajonal prim.Dr.“Daut Mustafa“ për periudhën kohore prej datës 01.01.2013 gjerë më 31.12.2013.

Nga shkresa e datës 10.12.2013 nënshkruar nga këtu i akuzuari vërtetohet se i akuzuari me dorën e vet ka shkruar:“S. Th. mami në akusheri ti vazhdohet kontrata sipas ligjit – pakufizuar“.

Nga kontrata nr.l247 vërtetohet se S. Th. ka themeluar marrëdhënien e punës për kohë të pacaktuar në Spitalin rajonal prim.Dr.“Daut Mustafa“ në Prizren duke filluar nga data 01.01.2014.

Në mbrojtjen e vet i akuzuari M. K. ka theksuar se sa i përket A. M., e njejta ka konkuruar në bazë të konkursit të hapur dhe se për te është nënshkruar kontrata për periudhën gjashtëmujore- në kohë të caktuar. Më pas është nënshkruar kontrata e përhershme dhe ate në bazë të nevojave dhe performancës së treguar në periudhën 7

mujore nga personat përgjegjës të Njesisë së gjinekologjisë, ku ka punuar edhe A. M. dhe ate nga motrat kryesore dhe shefi i repartit. Sa i përket S. Th. e njejta është pranuar në afat të caktuar të cilën edhe e lejon edhe Ligji i punës dhe Ligji për shërbyes civil dhe se kah fundi i vitit 2013 dhe se pas kontaktit me infermierët dhe motrën e repartit të gjinekologjisë ka dhënë urdhëresë me dorë që ti vazhdohet kontrata S. Th. si mami në akusheri sipas ligjit në kohë të pakufizuar. Në kohën derisa ka qenë drejtor në Spitalin rajonal të Prizrenit kontratat me punëtorët i ka lidhur ekskluzivisht ai pasi që kontratat paraprakisht janë pregaditur nga shërbimi i personelit dhe zyra ligjore. S. Th. bazuar në ligjin i cili lejon pranimin e punëtorëve në kohë të caktuar është pranuar pa konkurs, me kërkesë të shefit dhe motrës kryesore të repartit të gjinekologjisë. Ka shtuar se nuk ka qenë e nevojshme që të shpallet konkursi për punëtorët e lartëcekura kur është lidhur kontrata në kohë të pacaktuar me arsyetim se kanë kaluar paraprakisht të gjitha fazat e konkursit paraprak dhe se performanca pozitive e tyre e vlerësuar nga ana e shefit dhe nevoja për punëtorë ka bërë që me ta të lidhet kontrata në kohë të pacaktuar.

Në rastin konkret nuk është kontestues fakti se i akuzuari në cilësi të drejtorit të spitalit të Prizrenit iu ka vazhduar punëtorëve A. M. dhe S. Th. kontratat për kohë të caktuar dhe për kohë të pacaktuar pa konkurs, pas skadimit të afatit kohor për të cilën janë pranuar herën e parë në bazë të konkursit, pasqë ky fakt është vertetuar nga deklaratat e vet punëtorëve A. M. dhe S. Th. të ndëgjjuara në cilësi të dëshmitareve dhe dëshmitarit Q. G., si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit i cili nuk e ka mohuar faktin se punëtorëve të lartëcekura iu ka vazhduar kontratat me arsyetim se kanë kaluar paraprakisht të gjitha fazat e konkursit paraprak dhe se performanca pozitive e tyre e vlerësuar nga ana e shefit dhe nevoja për punëtorë ka bërë që me ta të lidhet kontrata në kohë të pacaktuar, pa konkurs. Mirëpo kontestuese është fakti se i akuzuari me këto veprime a e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Konform nenit 339 par.1 të KPK personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vehte ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër apo për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit. Ndërsa par.2. i nenit të njejtë parasheh që nëse vepra penale nga par.1. i këtij neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumë prej 2500 Euro, apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër kryesi dënohet me burgim deri në tri vjet.

Në rastin konkret i akuzuari M. K. me nënshkrimin e kontratave të lartëcekura së pari në kohë të caktuar e pastaj për kohë të pacaktuar pa shpalljen e konkursit dhe pranimin e punëtorëve në punë A. M. dhe S. Th., në cilësi të personit zyrtar – Drejtorit të Spitalit rajonal të Prizrenit ka bërë shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, pasi që ka shkelur nenin 8 pikën 1 dhe 2 të Ligjit të punës i cili parasheh që punëdhënësi në sektorin publik është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siq parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.

Poashtu, edhe në bazë të Rregullores mbi punësimin dhe përzgjedhjen në nenin 3 pika 3 parashihet që nëse për vendin e lirë të punës ka një ose më shumë kandidatë duhet që të shpallet konkursi publik për plotësimin e tij në pajtim me dispozitat e nenit 8 par.2. të Ligjit 03/L-2012 të punës.

Në bazë të lartëcekurave dhe provave të administruara dhe se pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar se këtu i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit të punës dhe të nenit 3 të Rregullores mbi punësimin dhe përzgjedhjen pasi që pa shpallur konkurs publik ka plotësuar vendet e lira të punës me punëtorët A. M. dhe S. Th. duke shkelur rëndë në këtë mënyrë të drejtat e personave tjerë. Andaj, bazuar edhe në të lartëcekurat gjykatara ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit M. K. janë formuar edhe elementet qenësore të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2.lidhur me par.1. të KPK, për çka edhe të njejtin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që i njëjti prej datës 04.05.2012 e deri më 31.nëntor.2012 në Prizren në cilësi të personit zyrtar – Drejtorit të Spitalit rajonal prim.Dr.Daut Mustafa në Prizren, duke e shfrytëzuar autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tija me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për personat e tjerë, në atë mënyrë që në kundërshtim me nenin 8 par.1. të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës, pa shpallur konkurs merr vendim për pranimin në marrëdhënie pune në kohë të caktuar A. M. me vendimin nr.11/07 të datës 04.05.2012 dhe të njejtën e punëson në vendin e punës mami, në boksën e lindjes, Departamenti për nëna dhe fëmijë në Spitalin rajonal prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, më datën 30.11.2014 poashtu merr vendimin me nr.11/45 për pranimin në marrëdhënie pune në kohë të caktuar S. Th., në punë dhe detyrat e punës së motrës akusherike në Repartin akusherik të Departamentit për nëna dhe fëmijë të Spitalit rajonal prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, më datën 03.12.2012 lidhë kontratën e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar me nr.5/31 me S. Th. për vendin e punës motër akusherike në Departamentin e njejtë për periudhën kohore prej 01.12.2012 gjerë më 31.12.2012, me datën 10.01.2013 lidhë kontratën e punës për kohë të caktuar me nr.1247 me S. Th. për vendin e punës mami në Repartin gjinekologjik për periudhën kohore prej 01.01.2013 deri më 31.dhjetor.2013 dhe në fund të dhjetorit të vitit 2013 lidhë kontratën për marrëdhënien e punës në kohë të pacaktuar nr.1247 me S. Th., me ç rast rëndë e shkel Ligjin e punës së Republikës së Kosovës, ndërsa këtyre dy të punësuarava i sjellë dobi të kundërligjshme në vlerën e të ardhurave personale të paguara.

Këtë gjendje faktike gjykata kryesisht e vërtetoi në bazë të deklaratave të dëshmitarëve të lartëcekur si dhe vet të akuzuarit i cili nuk e ka mohuar faktin se punëtorëve A. M. dhe S. Th. iu ka vazhduar kontratat pa shpallur konkurs publik, vetëm në bazë të referencave të stafit të repartit në të cilat të njejtat kanë punuar dhe nevojave për punëtorë.Poashtu i akuzuari nuk e ka mohuar faktin se në cilësi të drejtorit të spitalit kontratat me punëtorët i ka lidhur ekskluzivisht ai.

Andaj, duke i marrë parasysh këto fakte gjykata edhe vërtetoi se i akuzuari M. K. me veprimet e tija si person zyrtar – në cilësi të drejtorit të Spitalit regional prim. Dr.”Daut Mustafa” në Prizren ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të punës

dhe të rregullores mbi punësimin dhe përzgjedhjen, me ç rast edhe ka shkelur të drejtat e personave të tjerë duke e kryer në këtë mënyrë veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2.lidhur me par.1. të KPK,për çka edhe gjykata e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata ka marrë parasysh nenin 41 të KPP,i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në rastin konkret dhe se prej rrethanave lehtësuese gjykata ka marrë parasysh qëndrimin korrekt të akuzuarit në gjykim, faktin se është hera e parë që vie në kundërshtim me ligjin.Pasiqë rrethana rënduese nuk gjeti, gjykata është e mendimit se me një dënim të këtillë të shqiptuar si në dispozitiv do të mund të arrihet qëllimi i dënimin të paraparë me nenin 41 të KP që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij,të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale,ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit me qëllim të luftimit të këtyre dukurive të shëmtuara shoqërore në mënyrë që të ndalet hovi i zhvillimit të tyre të mëtutjeshëm.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti për krime të rënda

Më dt.12.04.2016, P.nr.69/15.

**Proçesmbajtësja
Sheqere Braha**

**Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi**

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.